

FLORA KOLECI

ANALIZË E FRAZAVE RELATIVE KUFIZUESE TË SHQIPES

1. Dy aspekte themelore lidhur me studimin e frazave relative

Struktura e frazave relative paraqet karakteristika të veçanta që e bëjnë të dallohet qartë nga llojet e tjera të frazave me nënrenditje. Ashtu siç është vënë tashmë në dukje për këto ndërtime të shqipes (Koleci 2006), lidhja që realizohet mes fjalisë kryesore dhe asaj të varur relative përfshin si mjetet e lidhjes, të cilët u përkasin klasave të ndryshme, (komplementues, përemra dhe ndajfolje lidhore), ashtu dhe fjalët apo sintagmat që shërbejnë si kokë relative. Këto e të tjerë elemente që ndihmojnë në realizimin e frazave relative, prej kohësh, kanë zgjuar interesin e gjuhëtarëve, të cilët, shpeshherë, e kanë përqendruar vëmendjen në çështje të ndryshme, por në mënyrë të veçantë, ashtu siç pohon dhe Bianchi (2002), studimi i relativeve është përballur me dy çështje kryesore: a) lidhja dhe b) modifikimi.

1.1 Çështja e procesit të lidhjes.

Ky aspekt ka të bëjë me lidhjen që ekziston mes dy pozicioneve të kokës relative, pozicionit që zë ajo në sintaksën e shfaqur dhe atij fillestar, argumental¹ në të cilin i është shënuar dhe roli tematik. Koka e relatives duket se kryen një rol të dyfishtë në strukturën e frazës. Nga njëra anë ajo përshtatet në rasë me foljen kallëzues të fjalisë kryesore, dhe kjo bëhet e qartë në gjuhët që kanë markues rase të dukshëm, siç është rasti i shqipes, rumanishtes (A. Cornilescu, 1993) gjermanishtes (G. Webelhuth, 1985) etj, gjuhë në të cilat vihet re përshtatja sipas treguesve të ndryshëm gramatikorë mes kokës së relatives dhe foljes kallëzues të fjalisë kryesore por, nga ana tjetër, nuk mund të mohohet lidhja e ngushtë e saj me foljen kallëzues të fjalisë së varur. Le t'i referohemi frazës së mëposhtme:

(1) Çështja për të cilën po diskutojmë, nuk është aq e thjeshtë

Në (1), koka e fjalisë relative 'çështja' rimerret në fjalinë e varur nga përemri lidhor i shoqëruar me parafjalë 'për të cilën'. Ky i fundit u përgjigjet kërkesave të foljes kallëzues të fjalisë së varur 'po diskutojmë' me anë të markuesve të rasës kallëzore. Duke parë këtë lidhje që realizohet mes kokës relative dhe foljeve kallëzues të fjalive kryesore dhe asaj të varur relative, shtrohet pyetja:

¹ Me pozicion argumental kuptojmë atë pozicion të frazës në të cilin zënë vend argumente të brendshme apo të jashtme. P.sh. 'Njeriu kafshoi mollën'. Në këtë fjali dallojmë argumentin e brendshëm 'mollën' dhe atë të jashtëm 'njeriu'. Secili nga këto ndodhet në një pozicion argumental të frazës, pasi aty u është shënuar roli tematik nga folja 'kafshoi'. Lidhur me shënimin e rasës shih Buxheli (2007).

cila nga këto dy folje i ka shënuar rolin tematik kokës relative? Dhe, për rrjedhje, cili është pozicioni fillestar, argumental në të cilin ajo është gjeneruar?

1.2 Çështja e procesit të modifikimit

Një aspekt i dytë i rëndësishëm është ai i modifikimit. Ndërkohë që aspekti i lidhjes shtron problemin e përcaktimit të vendit të gjenerimit të kokës relative, aspekti i modifikimit kërkon t'i japë shpjegim lidhjes që realizohet mes kokës relative dhe tërë fjalisë relative që e modifikon atë. Kështu, po t'i referohemi frazës (1), vëmë re se fjalia relative realizon një lidhje të veçantë me kokën relative 'çështje'. Fjalia relative lind si modifikues i kësaj fjale. Pyetja që shtrohet ka të bëjë me mënyrën e realizimit të procesit të modifikimit. Në lidhje me këtë çështje, studimet janë orvatur kryesisht të përcaktojnë llojin e kategorisë sintaksore të vetë fjalisë relative. Një ndër studimet më të hershme që kërkon t'i japë shpjegim statusit të fjalisë relative e gjejmë në atë që quhet analiza e determinantit, në punimin e Smith-it (1969). Sipas kësaj analize, një determinant i caktuar përzgjedh fjalinë relative, ndërkohë që kjo ndodhet në të djathtë të kokës së saj. Nga ana tjetër, kanë qenë të shumta studimet gjenerative që kanë arritur në përfundimin se fjalia relative i përket kategorisë së specifikuesit të sintagmës komplementuese, SpecCP (Hoekstra 1992, Bianchi 1999, etj.). Po ashtu nuk kanë munguar studimet që e shohin fjalinë relative si një projektim të foljes, për shkak se në gjuhë të ndryshme folja e fjalisë relative mban një markues morfologjik të veçantë (Afarli 1994)².

Por studimi i fjalive relative u thellua në konceptimin e strukturës së tyre me anë të analizës së sjellë nga Kayne-i (1994), (*Raising analysis*), i cili propozon *ngritjen e kokës relative*. Zanafillën e këtij propozimi e gjejmë në studimet e

² Për të parë konkretisht studimet që janë përballur me këto dy çështje që prekin strukturën e frazave relative, si ai i lidhjes dhe modifikimit, u referohemi disa prej analizave më të rëndësishme që kanë prekur si njërin ashtu dhe tjetrin aspekt:

a) Analiza e njëjtësisë së kokave relative (*The matching Analysis*) Chomsky (1965). Kjo analizë sjell idenë se ashtu si koka e jashtme (pra ajo që ndodhet në kufi të fjalisë kryesore) ekziston një kokë e brendshme (në brendësi të fjalisë relative) e cila është e njëjtë me të parën. Për shkak të njëjtësisë së tyre, koka e brendshme fshihet dhe zëvendësohet nga një përmër lidhor ose një komplementues: Më pëlqen libri që ~~(të bërë)~~ bleu Arbeni

b) Fjalia relative si një shtesë e kokës së jashtme (*Adjunction to the external head*) Në programin "Principet dhe parametrat", përsa u përket relativeve, mbizotëron ideja që ato janë një shtesë e kokës së jashtme, e cila ndodhet në fjalinë kryesore. Kështu, sipas kësaj analize fjalia relative shtohet në të djathtë të kokës relative dhe, teoria standarte X-bar, e shpjegon atë me anë të rregullës: [Nn [Nn ...Nn-1... CP] (Safir 1986, Fabb 1990).

c) Analiza e kokës së jashtme (The Head External Analysis). Studimet që i referohen kësaj analize janë të shumta (Chomsky 1977, Jackendoff 1977 etj.). Sipas kësaj analize, koka e fjalisë relative ka lindur jashtë saj. Brenda fjalisë relative realizohet lëvizja A-bar/A', (angl. A-bar/A' movement) e një operatori relativ i cili në bazë të parametrave që shfaqin gjuhët e ndryshme mund të jetë i shfaqur (overt) ose jo (covert). Për rrjedhje, sa kohë që koka nuk është brenda kësaj fjalie, ndryshe nga ç'propozohet në analizën matching, ajo nuk mund të rindërtohet në një pozicion të brendshëm të saj.

Smith-it (1969), Schachter-it (1973), dhe Vergnaud-it (1974) të cilët kishin hedhur idenë se fjalia relative, e cila në pozicionin fillestar të saj ndjek determinantin, zhvendoset pas kokës së relatives. Më vonë ajo u rimor nga Kayne-i (1994), i cili mund të themi vuri bazat e kësaj analize e cila pati një vazhdimësi të konsiderueshme (Bianchi 1999, etj.). Sipas kësaj analize, koka e relatives lind brenda fjalisë relative dhe më pas lëviz duke u ngritur drejt periferisë së majtë të frazës. Determinanti që shihet i lidhur me kokën relative nuk e shoqëron atë në lëvizjet brenda frazës. Ai gjenerohet jashtë fjalisë relative dhe realizon përzgjedhjen e kësaj të fundit. Pra, determinanti është i jashtëm dhe nuk formon një përbërës me kokën relative, por me gjithë sintagmën komplementuese.

Parë në këtë këndvështrim, Kayne (1994) e paraqet strukturën e një fraze relative si më poshtë:

(2) the [picture of himself_e [that [Bill saw [_e]]]]

Duke u mbështetur në të dhënat e kësaj analize, do të përpiqemi të sjellim analizën e frazave relative kufizuese të shqipes ku si mjete lidhëse shërbejnë përemrat dhe ndajfoljet lidhore³.

2. Frazat relative kufizuese me përemrin lidhor 'i/e cili/a'

Përemri lidhor, ndryshe nga komplementuesi *që*, mund të shoqërohet ose jo me parafjalë. Prania e kësaj të fundit luan një rol të veçantë në lidhjen me mjetin e lidhjes. Së pari, le t'u referohemi atyre ndërtimeve që nuk e lejojnë praninë e parafjalës:

2.1. Përemri lidhor i pashoqëruar me parafjalë

Mjeti kryesor që realizon lidhjen mes pjesëve përbërëse të frazave relative kufizuese është komplementuesi *që*, ndërsa përdorimi i përemrit lidhor në funksionin e kundrinorit të drejtë dhe të kryefjalës për këto lloje frazash përbën shkelje të normës . Përdorimi i tij është i këshillueshëm vetëm në rastet e shoqërimit të tij me parafjalë. Por pavarësisht kësaj, folësit mund t'i përdorin të dyja frazat e mëposhtme:

(3) a) Ata studentë *që* nuk janë regjistruar, nuk mund ta japin provimin


b) Ata studentë *të cilët* nuk janë regjistruar, nuk mund ta japin provimin

Si fraza (3a), ashtu dhe ajo (3b) janë relative kufizuese dhe sintaksa e shfaqur e kësaj të fundit nxjerr në pah tipare mjaft të ngjashme me të parën. Dallimi i vetëm qëndron në llojin e mjetit lidhës. Nëse tek e para, si mjet lidhës shërben komplementuesi *që*, tek fraza (3b), këtë rol e kryen përemri lidhor *të cilët*. Në një vështrim të përgjithshëm mund të kufizohesh vetëm në këtë

³ Lidhur me analizën e frazave relative që kanë si mjet lidhës komplementuesin *që*, shih F. Koleci-G. Turano (2011) *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, ShBLU, Tiranë.

ndryshim të dallueshëm në sintaksën e shfaqur, por në të vërtetë hapat e derivimit të këtyre ndërtimeve flasin për fraza që ndryshojnë dukshëm nga njëra-tjetra. Ndryshimi qëndron në vendin e gjenerimit dhe të shprehjes në sintaksën e shfaqur të mjetit të lidhjes dhe në lidhjen që ai realizon me sistemin komplementues. Ndryshe nga frazat relative me komplementuesin *që*, ku koka relative gjenerohet e vetme brenda sistemit komplementues (Koleci-Turano, 2011)⁴, në frazat relative që kanë si mjet lidhës një përemër lidhor, koka relative gjenerohet bashkë me këtë përemër si komplement i sintagmës foljore të këtij sistemi. Përemri lidhor i nënshtrohet një rregulle *Lëviz* (*Move*), në saje të së cilës lë pozicionin fillestar për t'u ngritur në një pozicion më të lartë të frazës. Për ta bërë më të qartë këtë, le t'u referohemi hapave të derivimit të kësaj fraze të paraqitur në skemën e mëposhtme⁵:

(4)



⁴ F. Koleci-G. Turano (2011), po aty, f. 144-150.

⁵ Lidhur me paraqitjen e strukturës së frazës, jemi mbështetur në modelin e propozuar nga L. Rizzi (1995) në *The Fine Structure of the Left Periphery*. Elements of Grammar. Dordrecht: Kluwer, 281-337.

Paraqitja në diagramë e strukturës së kësaj fraze na ndihmon të kuptojmë që, nën veprimin e rregullës së bashkimit *Merge* (Bashko), folja e fjalisë relative *janë regjistruar* është bashkuar me emrin *studentë*, e cila shërben si kokë relative e kësaj fjalisë dhe përemrin lidhor *të cilët*, që realizon lidhjen mes tyre. Në këtë bashkim emri dhe përemri shërbejnë si argumente të jashtme të foljes. Në saje të procesit të relativizimit, sintagma determinante që mbart kokën relative dhe përemrin lidhor i nënshtrohet rregullës së lëvizjes *Move*, e cila e ngre këtë sintagmë në një pozicion më të lartë të frazës, në SpecTop⁶. Përemri lidhor qëndron në pozicionin SpecTop ndërkohë që emri duhet t'i nënshtrohet një rregulle tjetër, asaj të përshtatjes *Agree*, pasi tiparet emërore të tij nuk mund të kontrollohen në këtë pozicion. Është determinanti *ata*, i gjeneruar jashtë sistemit komplementues, si kokë e sintagmës emërore i cili realizon kontrollin dhe legjitimin e tipareve emërore të emrit duke qenë se bashkëndajnë të njëjtat tipare. Për këtë arsye sintagma emërore që mbart kokën relative kryen një lëvizje të dytë duke lënë pozicionin SpecTop për t'u ngritur në pozicionin e specifikuesit të një tjetër sintagme, në SpecForce, i cili është dhe pozicioni përfundimtar i saj. Ajo çfarë vlen të theksohet këtu është vendi i gjenerimit të përemrit lidhor i cili gjenerohet dhe zhvendoset në frazë së bashku me kokën relative.

2.2 Fraza relative kufizuese me përemra lidhorë të shoqëruar me parafjalë

Siç është bërë tashmë e qartë, komplementuesi nuk mund të shoqërohet me parafjalë, pasi do të kishim ndërtime jogramatike si:

(5) Çështja për *që (të cilën) po diskutojmë....

Për këtë arsye, një rol të veçantë për realizimin e ndërtimeve të tilla fiton përdorimi i përemrit lidhor, i cili mund të shoqërohet nga parafjalë të rasave të ndryshme. Në analizën strukturore të frazave të tilla, lindin pyetje të ndryshme që kanë të bëjnë kryesisht me vendin e gjenerimit të parafjalës, raportit që ajo vendos me kategoritë e tjera qofshin këto leksikore apo funksionale dhe hapat e derivimit që çojnë në sintaksën e shfaqur të ndërtimeve të ndryshme ku ajo është pjesë e saj. Këto dhe të tjera kërkesa që shtrohen për studimin e strukturave të ngjashme do të analizohen duke marrë në shqyrtim një frazë të tillë si:

(6) Çështja për të cilën po diskutojmë, na përket të gjithëve


Në (6), kemi të bëjmë me një frazë relative kufizuese, ku dallojmë kokën relative *çështje* dhe determinantin *a*⁷. Ky i fundit e përzgjedh fjalinë relative si

⁶ Për sintagmat *Forcë* dhe *Topikë* shih Koleci-Turano 2011.

⁷ Lidhur me strukturën e sintagmës emërore dhe asaj determinante shih: G.Turano– Sh. Rrokaj (2000) *A proposito del sintagma nominale albanese. Il caso di un dimostrativo seguito da un DP definito*. *Lingua e Stile* Anno XXXV, nr. 1.

komplementin e saj. Ajo çfarë paraqet interes të veçantë në këtë frazë është mënyra e lidhjes mes fjalisë relative dhe kokës së saj, pasi mjeti lidhës shfaqet në trajtën e një sintagme parafjalore *për të cilin*. Për t'u dhënë përgjigje pyetjeve që shtruan më lart, po u referohemi hapave të derivimit të kësaj fraze, në mënyrë që të shohim se në ç'raport vendoset kjo parafjalë në lidhje me kokën relative, përemrin lidhor, dhe sistemin komplementues; ku gjenerohet dhe në ç'pozicion të frazës e gjejmë në sintaksën e shfaqur. Më poshtë është paraqitur struktura e kësaj fraze:

(7)



Ashtu si koka relative *çështje* dhe përemri lidhor *të cilën*, edhe parafjala *për*, që e shoqëron atë gjenerohet brenda sistemit komplementues si komplement i foljes së fjalisë relative *diskuto*. Ky komplement formohet nga një sintagmë parafjalore që ka si kokë të saj parafjalën *për*, e cila nga ana e saj projekton sintagmën determinante *të cilën çështje*. Ndërkohë që folja i bashkohet fleksionit në një pozicion më të lartë, komplementi i saj *për të cilën çështje i* nënshtrohet rregullës së lëvizjes *Move*, si rezultat e së cilës, i gjithë materiali zhvendoset drejt pozicionit të specifikuesit të sintagmës eptimore. Ndërkohë që parafjala dhe përemri qëndrojnë në SpecTop, sintagma emërore që mbart kokën relative *çështje i* nënshtrohet rregullës së përshtatjes *Agree*, e cila e kushtëzon të kryejë një tjetër lëvizje drejt pozicionit SpecForce. Dhe së fundi, koka emërore e kësaj sintagme *çështje* ngrihet në pozicionin e kokës së sintagmës determinante në të djathtë të determinantit *a*, pozicion që i lejon asaj

kontrollin dhe legjitimin e tipareve emërore që bashkëndan me këtë determinant. Në këtë fazë derivimi fraza e mësipërme merr trajtën *na përket të gjithëve çështja për të cilën po diskutojmë*. Për të përfutur sintaksën e shfaqur të frazës (6), e gjithë sintagma ForceP, së bashku me sintagmën determinante DP, i nënshtrohen një rregulle *Move*, e cila i ngrre ato në pozicionin e specifikuesit të sintagmës fleksionale SpecIP₂, e cila ndodhet në pozicionin më të lartë të frazës. Hapat e derivimit të kësaj fraze na ndihmojnë të kuptojmë se parafjala shfaqet si një bashkim i brendshëm (*internal merge*) në sintaksën e shfaqur, pra, vendi i gjenerimit të saj nuk përkon me atë të sintaksës së shfaqur. Parafjala zhvendoset nga pozicioni i saj argumental drejt një pozicioni të ri joargumental së bashku me sintagmën determinante që e merr si komplement të saj, por nuk ndikon në sintaksën e shfaqur të kësaj të fundit. Përemri lidhor zë të njëjtin pozicion SpecTopic, si në rastin kur del i vetëm ashtu dhe në rastet e shoqërimit të tij me parafjalë, por këtu është pjesë e një sintagme parafjalore.

3. *Relativet kufizuese që kanë si mjet lidhës një ndajfolje lidhore*

Krahas elementeve që dhe *i cili*, si mjet lidhës mes kokës dhe fjalisë relative mund të shërbejë edhe ndonjë ndajfolje lidhore si ajo e kohës *kur* dhe e vendit *ku*. Shoqërimi ose jo me parafjalë bën që ky mjet lidhës të kryejë një rol të dyfishtë në strukturën e frazës. Le t'i analizojmë konkretisht këto dy raste:


3.1. *Ndajfolja lidhore e pashoqëruar me parafjalë*

Karakteristikat që shfaqin ndërtimet relative që kanë si mjet lidhës një ndajfolje lidhore të pashoqëruar me parafjalë përafrojnë më shumë me frazat relative ku si mjet lidhës shërben komplementuesi që. Le t'i referohemi frazës së mëposhtme:

(8) Po përgatiste sallën ku do të mbledheshin

Kjo është një frazë relative kufizuese, ku lidhja mes kokës relative *sallë* dhe pjesës tjetër të fjalisë relative realizohet me anë të ndajfoljes lidhore *ku*. Struktura e kësaj fraze mund të paraqitet me anë të një skeme si më poshtë:

(9)



Hapat e derivimit të kësaj fraze na ndihmojnë të kuptojmë mënyrën e përfimit të strukturave të tilla. Ashtu siç është vënë re deri më tani, fjalia relative përzgjidhet nga determinanti, i cili gjenerohet jashtë kësaj fjalie, konkretisht nga determinanti *-n*. Koka relative *sallë* është gjeneruar si komplement i sintagmës foljore. Ky komplement është shënuar me etiketën PP, çka nënkupton që kemi të bëjmë me një sintagmë parafjalore *në sallë* dhe jo emërore *sallë*. Për këtë mund t'i referohemi të njëjtës frazë, ku si mjet lidhës shërben përemri lidhor *i cili*: *sallën në të cilën do të mblidheshin*. Si rezultat i procesit të relativizimit, sintagma parafjalore lë pozicionin e saj fillestar dhe ngrihet drejt periferisë së majtë të frazës në pozicionin SpecForceP₁. Duke qenë se determinanti *-n* i gjeneruar në pozicionin kokë të sintagmës determinante DP nuk mund të qëndrojë i vetëm, ai realizon tërheqjen e kokës N⁰ *sallë* në pozicionin D⁰, ku edhe e gjejmë në sintaksën e shfaqur. Në pozicionin më të lartë të kësaj fraze qëndron sintagma fleksionale *po përgatiste*, e cila merr si komplement të saj të gjithë fjalinë relative *sallën ku do të mblidheshin*. Ajo çfarë paraqet interes të veçantë në këtë frazë është fakti se vendi i gjenerimit të ndajfoljes lidhore *ku* përkon me pozicionin e sintaksës së shfaqur të tij Force⁰. Pra, mosshoqërimi i saj me parafjalë bën që ajo të sillet njësoj si komplementuesi *që*.


3.2 Ndajfolja lidhore e shoqëruar me parafjalë

Ashtu si përemri lidhor, edhe ndajfolja lidhore mund të shoqërohet me parafjalë të rasave të ndryshme. Kjo përbën një karakteristikë të veçantë të strukturës së këtyre ndërtimeve, përsa i përket vendit të gjenerimit të mjetit të lidhjes dhe sintaksës së shfaqur të tij. Nëse në ndërtimet e mësipërme pamë që ndajfolja, e cila realizonte lidhjen mes kokës dhe fjalisë relative gjenerohej ashtu si komplementuesi *që*, si një bashkim i jashtëm (*external Merge*) në pozicionin Force⁰, në rastet kur ajo shoqërohet me parafjalë e ndryshon vendin e gjenerimit dhe, njëkohësisht, vendin që zë në sintaksën e shfaqur. Në këto ndërtime, ai gjenerohet si komplement i një sintagme parafjalore, e cila, nga ana e saj, është komplement i një sintagme foljore. Le t'i referohemi frazës së mëposhtme:

(10) Nuk e njihnin atë vend për ku ishin nisur

Në këtë frazë, koka relative *vend* e realizon lidhjen me pjesën tjetër të fjalisë relative me anë të sintagmës parafjalore *për ku*. Në diagramën e mëposhtme janë paraqitur hapat e derivimit të kësaj fraze:

(11)



Ndajfolja lidhore *ku*, që shërben si mjet lidhës në këtë frazë, gjenerohet së bashku me kokën relative *vend* si komplement i sintagmës parafjalore, që ka si kokë të saj parafjalën *për*. Nga bashkimi i këtyre elementeve përftohet

sintagma parafjalore *për ku vend*, e cila shërben si komplement i sintagmës foljore VP, kokë e së cilës është folja *nis*. Si rezultat i procesit të relativizimit, sintagma parafjalore *për ku vend* i nënshtrohet një rregulle *Move*, e cila e ngrë atë drejt periferisë së majtë të frazës, në pozicionin e specifikuesit të sintagmës Topic të sistemit komplementues. Koka relative *vend*, e tërhequr nga determinanti *atë* ngrihet në pozicionin SpecForce, nga ku mund të realizojë kontrollin e tipareve që bashkëndan me këtë element.

Përfundime

Analiza e frazave relative nxjerr në pah tri elemente kyç të këtyre ndërtimeve: kokën relative, mjetin e lidhjes dhe determinantin. Determinanti nuk gjenerohet brenda fjalisë relative, por jashtë saj dhe e përzgjedh atë si komplementin e vet. Koka relative mund të jetë një argument i brendshëm apo i jashtëm, megjithatë pozicioni i saj argumental është brenda fjalisë relative, folja e së cilës i shënon asaj rolin tematik. Vendi i gjenerimit të kokës relative nuk përkon me vendin që zë ajo në sintaksën e shfaqur. Asaj i shënohet roli tematik nga folja e fjalisë relative dhe më pas, për shkak të relativizimit, ajo ngrihet në një pozicion joargumental (A') të frazës. Si mjet lidhës i fjalive në frazat relative mund të shërbejë komplementuesi *që*, përemri lidhor *i/e cili/a* dhe ndajfoljet lidhore *ku* e *kur*. Ndryshe nga frazat relative me komplementuesin *që*, ku koka relative gjenerohet e vetme brenda sistemit komplementues, në frazat relative që kanë si mjet lidhës një përemër lidhor, koka relative gjenerohet bashkë me këtë përemër si komplement i sintagmës foljore të këtij sistemi. Komplementuesi përftohet nga një bashkim i jashtëm (*external merge*), ndërsa përemri lidhor është një bashkim i brendshëm (*internal merge*). Ndajfolja lidhore sillet në mënyrë të dyfishtë në varësi të shoqërimit apo jo me parafjalë: në rastin e parë shfaqet në një pozicion joargumental, ndërsa në të dytin në një pozicion argumental.

Bibliografi

- Afarli, T.A. (1994) *A promotion Analysis of Restrictive Relative Clauses*. The Linguistic Review 11: 81-100.
- Bianchi, V. (1999) *Consequences of Antisymmetry for The Syntax of Headed Relative Clauses*. Doctoral Dissertation, Scuola Normale Superiore di Pisa.
- Bianchi, V. (2002) *Headed relative clauses in generative syntax*, Glot internacional, vol.6, Nr. 8 (235-247).
- Brame, M.K. (1976) *Conjectures and Refutations in Syntax and Semantics*. New York: North-Holland
- Buxheli, L. (2007) *Modelet e caktimit rator në gjuhën e sotme shqipe*, Neraida, Tiranë.

- Chomsky, N. (1977) *On Wh. Movement*. P.W. Culicover-, T. Wasow- A. Akmajin (eds.), *Formal syntax*. New York: Academic Press, 71-132.
- Chomsky, N. (1986) *Barriers*. Cambridge, Massachusetts: The MIT press.
- Chomsky, N. (1965) *Aspects of the Theory of Syntax*. Cambridge, Massachusetts: The MIT Press.
- Chomsky, N. (1995) *The minimalist program*. Cambridge, Massachusetts: The MIT press.
- Chomsky, N-
H.Lasnik (1995) *Principles and parameters theory*.
- Cinque, G. (1982) *On the theory of relative clauses and markedness*, *The Linguistic Review* 1: 247-296.
- Cinque, G. (1988) *La frase relativa*, in: L. Renzi (ed.), *Grande grammatica italiana di consultazione*, Volume I. Bologna: Il Mulino.
- Cipo, K. (1952) *Sintaksa*, Tiranë.
- Cornilescu, A (1993) *Remarks on the Determiner System of Rumanism: The Demonstratives al and cel*, *Probus* 4: 189-260.
- Domi, M. (1954) *Gramatika e gjuhës shqipe*, Pjesa II. Sintaksa. Tekst për shkollat tetëvjeçare e shkollat e mesme, Tiranë.
- Domi, M (1966) *Gramatika e gjuhës shqipe*, Pjesa II. Sintaksa. Tekst për shkollat pedagogjike, Tiranë.
- Domi, M. (1970) *Mbi një tip strukturor të fjalive të varura dhe mbi disa përgjithësime të lidhura me të*. SF. 1970/4. Tiranë.
- Fabb, N. (1990) *The difference between English Restrictive and Appositive Clauses*, *Journal of Linguistics* 26: 57-77.
- Floqi, S. (1956) *Disa tipe semantiko-strukturorë të periudhës me fjali të varur në shqipen e sotme*. Konferenca e studimeve albanologjike, Tiranë.
- Floqi, S. (1967) *Disa tipe semantiko-strukturorë të periudhës me fjali të varur me lidhje korrelative*. SF. 1967/3. Tiranë.
- Hoekstra, E. (1992) *On the parametrization of Functional Projection in CP*, *NELS* 23: 191-204
- Kayne, R.S. (1994) *The Antisymmetry of Syntax*, The MIT Press Cambridge, Massachusetts, London, England.
- Turano, G. (2011) *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, ShBLU, Tiranë.
- Koleci, F (2006) *Frazat relative të shqipes parë nën këndvështrimin gjenerativist*.
- Memushaj, R. (2008) *Gjuhësia gjenerative*, Tiranë.
- Mita, J. (2000) *Struktura e sintagmave në gjuhën shqipe vështruar sipas gjenerativizmit*. Studime albanologjike 2000/2.

- Safir, K. (1986) *Relative Clauses in a Theory of Binding and Levels*. Linguistic Inquiry 17, 663-689
- Schachter, P. (1973) *Focus on Relativisation*, Language 49: 19-46.
- Smith, C. S. (1969) *Determiners and Relative Clauses in a Generative Grammar of English*, Language 40, 37-52
- Rizzi, L. (1995) *The Fine Structure of the Left Periphery*. Elements of Grammar. Dordrecht: Kluwer, 281-337.
- Rizzi, L. (2005) *The Structure of Internally Headed Relative Clauses*. Structure and Beyond, The Cartography of Syntax Structures, Volume 3. Oxford, University Press.
- Turano, G. –
- Rrokaj, Sh. (2000) *A proposito del sintagma nominale albanese. Il caso di un dimostrativo seguito da un DP definito*. Lingua e Stile Anno XXXV, nr. 1.
- Prifti, S. (1972) *Klasifikimi i fjaltive të varura*. SF. 1972/2.
- Totoni, M. (2000) *Fraza me fjali të nënrenditur sintetike*. Tiranë. Gramatika e gjuhës shqipe II. Tiranë (1997)
- Vergnaud, J. R. (1974) *French Relative Clauses*. Ph.D Dissertation , MIT.
- Vries, M (2006) *The syntax of oppositive relativization: On specifying, false free relatives, and promotion*. Linguistic Inquiry 37: 229-270.

SUMMARY

In this paper, we focus on the status of the relative pronouns and some adverbs in the raising analysis of Albanian restrictive relative clauses and in *pied piping* relatives. According to Kayne (1994), the relative pronouns are actually the original determiners of the relative ‘head’. Then it is the constituent [_{DP} *i/e cili/a* (who) NP] that raises to Spec,CP. Basing on the Complementizer system proposed by Rizzi (1995), under our assumptions, in the Albanian complementizer system there are two positions available for relativization, namely Spec, ForceP and Spec, TopicP. In the contrast of *that*-relatives in the *ho*-relatives, the relative determiner moves to the SpecTopic (the former is an *external merge* and the latter is an *internal merge*). As a consequence, we assume a two steps derivation: first the relative DP moves to the Spec of TopicP, then the NP “head” raises to Spec, ForceP.